



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opstina Istok
Istog Municipality

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.736/22

Dt.06.10.2022

Duke u bazuar në nenin 67 dhe 68, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 5 pika c e Ligjit Nr.03/L-068 për Arsim në Komunitet në Republikën e Kosovës, nenit 37 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, UA-MPMS, Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.34/2014 Funksionim i Shërbimit Pedagogjik-Psikologjik në Shkollë, Drejtori Komunal i Arsimit në Istog shpallë këtë:

KONKURS

I. Titulli i vendit të punës; Psikolog në IAAP "Mithat Frasheri" Gurrakoc

Institucioni:	Komuna e Istogut
Departamenti/Drejtoria:	Drejtoria Komunale e Arsimit
Lloji i pozites:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i pozitave:	(1) Një
Titulli i mbikëqyrësit:	Drejtori i Shkollës
Grada/Koeficienti:	6
Kohëzgjatja :	I/e karrierës (Punë provuese 6 muaj)
Ore punë në javë:	40

Detyrat dhe përgjegjësitë për vendin e punës;

- Psikologu ka detyrë të kontribuojë në lehtësimin e procesit të të nxënës dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional social dhe personal të nxënësit
- Psikologu ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë arteret në shkollë
- Psikologu punon me nxënës për të zhvilluar strategji efektive të të nxënës, zhvillim social e personal të nxënësit
- Psikologu bashkëpunon me mësuesin, prindër dhe komunitetin

- Psikologu ofron konsultime me mësime, prindër dhe komunitetin me qëllim të shëndetit sa me të mirë të nxënësve.
- Psikologu bashkëpunon me institucione profesionale të shkollës, institucione të tjera sociale dhe shëndetësore dhe organizata të tjera me qëllim të përvetësimit të praktikave të mira.

Për vendin e punës psikolog, kërkohet përgatitje shkollore

Për vendin e punës psikolog, kërkohet përgatitje shkollore e nivelit Master në Fakultetin Filozofik, degën e Psikologjisë - drejtimi: Psikologji shkollore dhe këshillim, (apo siç është rregulluar me UA 2014 për licencimin e mësimeve dhe bashkëpunëtoreve profesional).

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal,
- Certifikata e lindjes,
- Kopja e diplomës ose certifikata në vend të diplomës, jo më e vjetër se gjashtë muaj, çdo certifikatë me e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh.
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t' i kenë diplomat e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime, jo më e vjetër se 6 muaj
- Dëshmia e përvojës së punë.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 07.11.2022 deri 21.11.2022

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100, kati përdhës dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës, po në të njëjtën zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje, Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë.

Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit, ndërsa i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrin pas afatit nuk do të shqyrtohet.

Gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit (kërkesën) do të refuzohet.



Drejtori i DKA-së
Naim Behlulaj

Naim Behlulaj